

VENDIM
Nr. 586, datë 30.8.2019

PËR PUNËSIMIN E PËRKOHSHËM TË STUDENTËVE TË EKSELENCËS NË
INSTITUCIONET E ADMINISTRATËS SHTETËRORE

(Ndryshuar me VKM nr. 229, datë 18.3.2020; nr. 665, datë 10.11.2021; nr. 237, datë 20.4.2023; nr. 101, datë 11.2.2026)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Krijimin e kushteve të nevojshme për studentët e ekselencës, për të krijuar eksperiencë të përshtatshme pune, me qëllim zhvillimin e karrierës së tyre të mëvonshme në administratën publike shqiptare.

2. Për realizimin e qëllimit të përcaktuar në pikën 1, të këtij kreu, pozicionet vakante të kategorisë ekzekutive (specialist dhe të barasvlefshëm) në institucionet e administratës shtetërore, për çdo vit kalendarik, të plotësohen me prioritet nga studentët e ekselencës, nëpërmjet punësimit të tyre me kontratë të përkohshme 1-vjeçare, me përjashtim të pozicioneve të punës për të cilat kërkohet plotësimi i kriterëve të veçanta, në lidhje me vjetërsinë dhe/apo zotërimin e certifikimeve të ndryshme.

3. Numri i pozicioneve, që do të vihen në dispozicion të studentëve të ekselencës, për çdo vit kalendarik, nuk mund të jetë më i madh se një e treta e numrit të pozicioneve të institucionit.

4. Në kuptim të këtij vendimi, me termat e mëposhtëm nënkuptohet:

a) “Institucione të administratës shtetërore”, institucionet e përcaktuara në ligjin për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore, me përjashtim të:

i. njërive të drejtpërdrejta të ofrimit të shërbimeve në fushën e shëndetësisë, arsimit, artit dhe kulturës;

ii. Policisë së Shtetit (punonjësit me statusin e policisë së shtetit);

iii. shërbimit diplomatik (punonjësit me grada diplomatike);

iv. Forcave të Armatosura (punonjësit me grada);

v. institucioneve që aplikojnë sisteme të tjera me grada (punonjësit me grada).

b) “Studentë të ekselencës”, studentët, të cilët kanë përfunduar studimet universitare:

i. në ciklin e parë ose të dytë të studimit të arsimit të lartë, me notë mesatare 9 - 10 ose ekuivalent me të, në institucionet e huaja të arsimit të lartë, institucionet publike të arsimit të lartë apo institucionet/programet e akredituara jopublike të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, në varësi të diplomës së kërkuar për pozicionin e punës vakant ku aplikon;

ii. jo më herët se 3 (tri) vite përpara vitit kalendarik për të cilin po zhvillohet procedura.

5. Diplomati e përfituara jashtë vendit duhet të jenë të njohura dhe të njësuar sipas legjisllacionit në fuqi për arsimin e lartë.

II. PROCEDURA E PUNËSIMIT

1. Procesi i përzgjedhjes dhe emërimit menaxhohet nga Departamenti i Administratës Publike, në bashkëpunim me Kryeministrinë dhe ministrinë e linjës, dhe realizohet nëpërmjet një procedure konkurrese, e cila zhvillohet në dy faza:

a) Verifikimi paraprak, i cili ka për qëllim të verifikojë nëse kandidatët plotësojnë kërkesat e përcaktuara në pikën 4, të kreut I, të këtij vendimi;

- b) Vlerësimi i kandidatëve, ku përfshihet vlerësimi:
- i. mbi bazën e mesatares së ponderuar;
 - ii. mbi bazën e nivelit të diplomës, vendit ku është kryer studimi dhe institucionit të arsimit të lartë;
 - iii. i angazhimeve të kandidatëve në aktivitete ekstrakurrikulare, vullnetarizmi dhe skema mobiliteti.
2. Llogaritja e totalit të pikëve të vlerësimit të grumbulluara nga kandidatët është sipas metodologjisë së vlerësimit të përcaktuar në lidhjen nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Departamenti i Administratës Publike shpall publikisht në faqen e tij zyrtare dhe në platformën “punetembare.gov.al”, për çdo vit kalendarik, thirrje për shprehjen e interesit të studentëve të ekselencës, të cilët duan të punësohen përkohësisht në institucionet e administratës shtetërore.
4. Shpallja publike për shprehjen e interesit, sipas pikës 3, të këtij kreu, përmban të dhëna në lidhje me pozicionet vakante të grupuara, bazuar në kriterin e nivelit dhe të llojit të diplomës (fusha e studimit) që kërkon pozicioni i punës, si dhe çdo përcaktim tjetër, që lidhet me procedurën përkatëse.
5. Dokumentacioni duhet të dorëzohet elektronikisht në portalin e rekrutimit, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendrike nga dita e parë e shpalljes në faqen zyrtare të DAP-it dhe në platformën “punetembare.gov.al”.
6. DAP-i, në bazë të dokumentacionit të paraqitur, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pune, nga data e mbylljes së afatit të dorëzimit të tyre, bën verifikimin paraprak të kandidatëve, që përmbushin kërkesat e përcaktuara në pikën 4, të kreut I, të këtij vendimi, dhe krijon listën e kandidatëve të kualifikuar, duke i renditur ata sipas pikëve të grumbulluara.
7. Lista e përgatitur sipas pikës 6, të këtij kreu, përmban për secilin nga kandidatët:
- a) pikët e grumbulluara;
 - b) grupet e pozicioneve në të cilat ata kanë të drejtë të përzgjedhin pozicionin e punës, sipas kriterit të nivelit dhe llojit të diplomës që kërkon pozicioni i punës.
- Kandidatët, të cilët kanë diplomë të niveleve më të larta se ai që kërkon pozicioni i punës, renditen në të gjitha grupet e pozicioneve të fushës përkatëse të studimit, pavarësisht nga niveli i diplomës së kërkuar për grupin përkatës.
8. DAP-i shpall listën e përgatitur sipas pikave 6 e 7, të këtij kreu, në faqen zyrtare të tij dhe në platformën “punetembare.gov.al”. Kandidatët që nuk kualifikohen njoftohen individualisht nga DAP-i, duke specifikuar edhe arsyen e moskualifikimit.
9. DAP-i, brenda 5 (pesë) ditëve pune, nga data e krijimit të listës sipas pikave 6 e 7, të këtij kreu, thërret kandidatët, të cilët, duke filluar nga ai me pikë më të larta brenda grupit përkatës, përzgjedhin pozicionin ku duan të emërohen në mënyrë të përkohshme.
10. Në rastet e kandidatëve me pikë të barabarta, e drejta e përzgjedhjes përcaktohet, si më poshtë vijon:
- a) Në rast se njëri prej kandidatëve i përket kategorisë së personave me aftësi ndryshe, atëherë ka të drejtë të përzgjedhë ai i pari, në raport me kandidatët e tjerë;
 - b) Në rast se nuk mund të aplikohet alternativa e mësipërme, atëherë e drejta e përzgjedhjes përcaktohet me short, në prani të tyre.
11. DAP-i, brenda 5 (pesë) ditëve pune, nga përfundimi i procesit, sipas pikës 9, të këtij kreu:
- a) publikon në faqen e tij zyrtare dhe në platformën “punetembare.gov.al” listat e kandidatëve që kanë përzgjedhur pozicionet e punës;
 - b) dërgon pranë institucioneve të administratës shtetërore listat e kandidatëve, të cilët kanë përzgjedhur pozicionet e punës për secilin institucion.

12. Institucionet e administratës shtetërore lidhin kontratat e përkohshme të punës me kandidatët, sipas listës së dërguar nga DAP-i, e cila respekton përputhshmërinë e nivelit dhe të fushës së studimit me kriterin e nivelit dhe të llojit të diplomës për pozicionin përkatës të punës.

13. Marrëdhëniet e punës së kandidatëve, të cilët lidhin kontratat e punës për periudhën 1-vjeçare, rregullohen në bazë të dispozitave të Kodit të Punës.

14. Në përfundim të kontratës 1-vjeçare, të lidhur sipas këtij vendimi, ata që dëshirojnë të bëhen pjesë e shërbimit civil do t'i nënshtrohen procedurave të konkurrimit, sipas legjislacionit të shërbimit civil.

15. Nëse në përfundim të procedurës së përcaktuar në pikën 12, të këtij kreu, nga grupi i pozicioneve të institucioneve, pjesë e shërbimit civil, të dedikuara për studentët e ekselencës për vitin kalendarik përkatës, ka ende pozicione të lira, DAP-i vijon procedurat e plotësimit të këtyre pozicioneve sipas legjislacionit të shërbimit civil.

16. Studentët e ekselencës kanë të drejtë të përfitojnë vetëm një herë nga skema e punësimit sipas procedurave të këtij vendimi.

III. DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

1. Ngarkohet ministria përgjegjëse për arsimin:

a) të vërë në dispozicion të Departamentit të Administratës Publike listën e institucioneve publike të arsimit të lartë dhe të institucioneve/ programeve të akredituara jopublike të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, brenda 10 (dhjetë) ditëve, nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, dhe në vazhdimësi, sa herë ka ndryshime;

b) të bëjë ekuivalencën e mesatares së kandidatëve që kanë përfunduar studimet jashtë apo brenda Shqipërisë, në rast se përdoret sistem i ndryshëm vlerësimi, rast pas rasti, sipas kërkesës së DAP-it.

2. Përfundimisht për vitin 2019:

a) ngarkohet Departamenti i Administratës Publike të bëjë një thirrje për shprehje interesi në muajin gusht 2019;

b) kanë të drejtë të aplikojnë për thirrjen, sipas përcaktimit në shkronjën “a”, të kësaj pike, studentët e ekselencës që kanë përfunduar studime universitare duke filluar nga viti 2015.

2/1. Përfundimisht për vitin 2020, afati i kontratës së lidhur për studentët e ekselencës të punësuar në pozicione të shërbimit civil, sipas procedurave të thirrjes së parë të publikuar në janar 2019, shtyhet deri në përfundim të procedurave të rekrutimit në shërbimin civil, për këto pozicione pune.

2/2. Përfundimisht për vitin 2021:

a) pozicionet e dedikuara për studentët e ekselencës, për këtë vit, të plotësohen nga kandidatët e përzgjedhur nëpërmjet platformës “Gati për Shqipërinë”, sipas së njëjtës metodologji të vlerësimit të kandidatëve të përcaktuar në pikat 1, shkronja “b”, dhe 2, të kreut II, të këtij vendimi;

b) Departamenti i Administratës Publike të zhvillojë procedurën e radhës së punësimit të përkohshëm të studentëve të ekselencës, sipas përcaktimeve të kreut II, të këtij vendimi, nëse në përfundim të procedurës së zhvilluar sipas shkronjës “a”, të kësaj pike, mbeten ende pozicione vakante të dedikuara për studentët e ekselencës.

2/3. Përfundimisht, për vitin 2023, për studentët e ekselencës të punësuar me kontratë të përkohshme 1-vjeçare në institucionet e administratës shtetërore, sipas procedurave të thirrjes së publikuar në vitin 2022, afati i kontratës së tyre shtyhet deri në përfundim të procedurave të punësimit, sipas legjislacionit specifik që rregullon marrëdhënien e punës në këto institucione.

2/4. Përfundimisht për vitin 2026, për studentët e ekselencës të punësuar me kontratë të përkohshme 1-vjeçare në institucionet e administratës shtetërore, sipas procedurave të thirrjes së publikuar në dhjetor 2024, afati i kontratës së tyre të shtyhet deri në përfundim të

procedurave të punësimit, sipas legjislacionit specifik, që rregullon marrëdhënien e punës në këto institucione.

3. Vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 766, datë 26.12.2018, “Për punësimin e studentëve të ekselencës në institucionet e administratës shtetërore, pjesë e shërbimit civil”, dhe nr. 812, datë 26.12.2018, “Për punësimin e studentëve të ekselencës në institucionet e administratës shtetërore, jashtë shërbimit civil”, shfuqizohen.

4. Ngarkohet Departamenti i Administratës Publike, ministria përgjegjëse për arsimin dhe të gjitha institucionet e tjera të administratës shtetërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Lidhja nr. 1

METODOLOGJIA E VLERËSIMIT

1. Bazuar në pikën 2, të kreut 2, të këtij vendimi, kandidatët e kualifikuar për të përzgjedhur pozicion pune vlerësohen në bazë të:

- a) mesatares së ponderuar;
- b) nivelit të diplomës, vendit ku është kryer studimi dhe institucionit të arsimit të lartë;
- c) angazhimeve në aktivitetet ekstrakurrikulare, vullnetarizmit dhe skemave të mobiliteti.

2. Për vlerësimin sipas shkronjës “a”, të pikës 1, të kësaj lidhjeje, kandidatët përfitojnë pikët sipas tabelës së llogaritjes së mesatares, bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Për efekt të procedurës së punësimit të studentëve të ekselencës, sipas këtij vendimi, vlerësohet me pikë mesatarja e ponderuar e diplomës me të cilën kandidati konkurron, përkatësisht mesatarja e ponderuar e diplomës:

- a) “Bachelor”, në rast se kandidati konkurron me këtë nivel diplome;
- b) “Master profesional”, në rast se kandidati konkurron me këtë nivel diplome;
- c) “Master shkencor”, në rast se kandidati konkurron me këtë nivel diplome;
- ç) “Doktor”, në rast se kandidati konkurron me këtë nivel diplome.

4. Për vlerësimin sipas shkronjës “b”, të pikës 1, të kësaj lidhjeje, kandidatët përfitojnë pikë shtesë mbi pikët e mesatares, si më poshtë vijon:

a) Studentët e diplomuar në institucionet e arsimit të lartë në një nga vendet anëtare të OECD-së ose BE-së si dhe studentët që kanë përfunduar studimet jashtë vendit me mbështetje të përfituar nga qeveria shqiptare, për nivelin e diplomës:

- i. “Doktor” – 170 (njëqind e shtatëdhjetë) pikë;
- ii. “Master shkencor”, “Master profesional, të përfituar në fund të studimeve të ciklit të dytë, me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike”, ose të barasvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë – 140 (njëqind e dyzet) pikë;
- iii. “Master profesional” ose të barasvlefshme me të, sipas legjislacionit të arsimit të lartë – 110 (njëqind e dhjetë) pikë;
- iv. “Bachelor” ose të barasvlefshme me të, sipas legjislacionit të arsimit të lartë – 80 (tetëdhjetë) pikë.

b) Studentët e diplomuar në institucionet publike të arsimit të lartë në Shqipëri, për nivelin e diplomës:

- i. “Doktor” – 110 (njëqind e dhjetë) pikë;

ii. “Master shkencor”, “Master profesional të përfutur në fund të studimeve të ciklit të dytë, me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike”, ose të barasvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë – 80 (tetëdhjetë) pikë;

iii. “Master profesional” ose të barasvlefshme me të, sipas legjislacionit të arsimit të lartë – 50 (pesëdhjetë) pikë;

iv. “Bachelor” ose të barasvlefshme me të, sipas legjislacionit të arsimit të lartë – 20 (njëzet) pikë.

c) Studentët e diplomuar në institucionet/programet e akredituara jopublike të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë dhe studentët e diplomuar në vende të tjera jashtë Shqipërisë, të ndryshme nga përcaktimi i shkronjës “a”, të pikës 3, të kësaj lidhjeje, për nivelin e diplomës:

i. “Doktor” – 100 (njëqind) pikë;

ii. “Master shkencor”, “Master profesional të përfutur në fund të studimeve të ciklit të dytë, me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike”, ose të barasvlefshme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë – 70 (shtatëdhjetë) pikë;

iii. “Master profesional” ose të barasvlefshme me të, sipas legjislacionit të arsimit të lartë – 40 (dyzet) pikë;

iv. “Bachelor” ose të barasvlefshme me të sipas legjislacionit të arsimit të lartë – 10 (dhjetë) pikë.

ç) Për vlerësimin sipas shkronjës “c”, të pikës 1, të kësaj lidhjeje, kandidatët përfitojnë pikë shtesë, si më poshtë vijon:

i. për aktivitete ekstrakurrikulare, të tilla si angazhim në projekte të ndryshme, pjesëmarrje në konkurrenca apo olimpiada të ndryshme, pjesëmarrje në grupe pune konferencash apo punime konferencash – 2 (dy) pikë;

ii. për aktivitete vullnetarizimi, ku përfshihen angazhimet në ofrimin e shërbimeve për të përmirësuar jetën e komunitetit, për të cilat nuk përfitohet shpërblim monetar – 3 (tre) pikë;

iii. për pjesëmarrje në skema mobiliteti, të tilla si zhvillimi i një periudhe studimi (semestër/vit akademik) në një institucion të arsimit të lartë jashtë vendit ku kryhen studimet (psh ERASMUS, etj) – 5 (pesë) pikë.

d) Aktivitetet e përcaktuara në pikën 4, të kësaj lidhjeje, duhet të pasqyrohen në jetëshkrim dhe të vërtetohen me dokument zyrtar.

dh) Kandidatët duhet të dorëzojnë si pjesë të dokumentacionit vetëm një diplomë, për të cilën ata mendojnë se favorizohen në përputhje me grupet e pozicioneve të shpallura dhe me metodologjinë sipas këtij vendimi. Në rast se dorëzojnë më shumë se një të tillë, Departamenti i Administratës Publike do të gjykojë vetëm për njërin prej tyre, atë që i favorizon ata në grumbullimin e pikëve sipas metodologjisë.

Tabela e llogaritjes së mesatares

Mesatarj a	Pikët
9.00	0.00
9.01	0.20
9.02	0.40
9.03	0.60
9.04	0.80
9.05	1.00
9.06	1.20
9.07	1.40
9.08	1.60
9.09	1.80

Mesatarj a	Pikët
9.51	10.20
9.52	10.40
9.53	10.60
9.54	10.80
9.55	11.00
9.56	11.20
9.57	11.40
9.58	11.60
9.59	11.80

9.10	2.00
9.11	2.20
9.12	2.40
9.13	2.60
9.14	2.80
9.15	3.00
9.16	3.20
9.17	3.40
9.18	3.60
9.19	3.80
9.20	4.00
9.21	4.20
9.22	4.40
9.23	4.60
9.24	4.80
9.25	5.00
9.26	5.20
9.27	5.40
9.28	5.60
9.29	5.80
9.30	6.00
9.31	6.20
9.32	6.40
9.33	6.60
9.34	6.80
9.35	7.00
9.36	7.20
9.37	7.40
9.38	7.60
9.39	7.80
9.40	8.00
9.41	8.20
9.42	8.40
9.43	8.60
9.44	8.80
9.45	9.00
9.46	9.20
9.47	9.40
9.48	9.60
9.49	9.80
9.50	10.00

9.60	12.00
9.61	12.20
9.62	12.40
9.63	12.60
9.64	12.80
9.65	13.00
9.66	13.20
9.67	13.40
9.68	13.60
9.69	13.80
9.70	14.00
9.71	14.20
9.72	14.40
9.73	14.60
9.74	14.80
9.75	15.00
9.76	15.20
9.77	15.40
9.78	15.60
9.79	15.80
9.80	16.00
9.81	16.20
9.82	16.40
9.83	16.60
9.84	16.80
9.85	17.00
9.86	17.20
9.87	17.40
9.88	17.60
9.89	17.80
9.90	18.00
9.91	18.20
9.92	18.40
9.93	18.60
9.94	18.80
9.95	19.00
9.96	19.20
9.97	19.40
9.98	19.60
9.99	19.80
10.0	20.00